

VENDIM
Nr.831, datë 30.11.2011

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16, të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 04240 “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes”, artikulli 600, “Paga personeli”, të shtohet fondi prej 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 04240 “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes”, artikulli 601 “Sigurime shoqërore e shëndetësore”, të shtohet fondi prej 714 000 (shtatëqind e katërmbëdhjetë mijë) lekësh.

c) Në programin buxhetor 04250 “Zhvillimi rural duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë, agroindustrinë dhe marketingun”, artikulli 601, “Sigurime shoqërore e shëndetësore”, të shtohet fondi prej 307 000 (treqind e shtatë mijë) lekësh.

ç) Në programin buxhetor 04220 “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, artikulli 600 “Paga personeli”, të zbritet fondi prej 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekësh.

d) Në programin buxhetor 04220 “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, artikulli 601 “Sigurime shoqërore e shëndetësore”, të zbritet fondi prej 1 021 000 (një milionë e njëzet e një mijë)lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha